

**PROPOZIM - ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**

EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE

KLASA III



KLASA III

EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE



EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE NË MËSIMIN KLASOR

- Doracak për mësimdhënës për klasën e III-të -

Botues: Instituti Maqedonas për Media
rr. "Jurij Gagarin", 17/1-1
1000 Shkup, Maqedonia e V.

Byroja për Zhvillim të Arsimit
rr. "Rugjer Boshkoviç", nr.20
1000 Shkup, Maqedonia e V.

Redaktorë: Mitko Çashllarov
Ajshe Ajrullai

Autorë: Marina Dimitrieva – Gjorgjievska
Olivera Todoroska
Mitko Çashllarov
Ajshe Ajrullai

Redaksia profesionale: Mihajlo Llahtov
Vesna Nikodonoska

Përkthyes: Sefer Tahiri


Lektor: Shpëtim Hiseni

Dizajni dhe përpunimi teknik: Koma dizajn

Doracaku është punuar në kuadër të Projektit të USAID për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë", të cilin e realizojnë IREX dhe partnerët lokalë Instituti Maqedonas për Media, Instituti për Studime të Komunikimit dhe Forumi Arsimit Rinor, në bashkëpunim me Byronë për Zhvillim të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Përkrahja për përpilimin e Doracakut është siguruar nga populli amerikan nëpërmjet Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja e Doracakut është përgjegjësi e IREX dhe e Institutit Maqedonas për Media (IMM) dhe nuk l reflekton qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.





Hyrje

Sot, në kohën e një “realiteti të ri mediatic”, kur të rinjtë janë të ekspozuar ndaj një sasive të madhe informacioni në baza ditore, përmes platformave dhe teknologjive mediatike tradicionale dhe veçanërisht digjitale, është e nevojshme, përmes arsimit, në shkollë, të fitohen njohuri dhe aftësi për rishqyrtimin kritik të përmbajtjeve mediatike. Është e nevojshme që nxënësit të jenë në gjendje të dallojnë “kryesoren dhe dytësoren” në gjithçka që lexojnë, dëgjojnë ose shohin, të njohin elementet e propagandës ose mesazheve të fshehura reklamuese, të njohin gjuhën e urrejtjes implicite dhe eksplicite. Përmes mësimdhënies, nxënësit duhet të aftësohen të përdorin në mënyrë efektive informacionet, përmbajtjet dhe platformat mediatike, ndërkaq përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në media të ndryshme sociale, pritet që ata të veprojnë me përgjegjësi dhe në mënyrë kritike të qasën përmbajtjes që “krijojnë”.

Në këtë drejtim, edukimi mediatic futet në planet dhe programet e reja me rezultate të caktuara të të nxënësve, përmbajtje, standarde për vlerësim dhe shembuj të aktiviteteve me të cilat nxënësit do të kenë qasje më të përgjegjshme në media, do të analizojnë mesazhet dhe do të vlerësojnë informacionet në të cilat kanë qasje, do të përdorin informacionet që pranojnë përmes mediave dhe vetë do të krijojnë mesazhe mediatike në një mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.

Në programet mësimore nga klasa e parë deri në klasën e pestë të arsimit fillor, mësimi i edukimit mediatic është i integruar në një numër përmbajtjesh dhe aktiviteteve në lëndë të ndryshme mësimore. Kështu, në kuadër të programit mësimor në lëndët gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake, është zhvilluar një fushë e veçantë e titulluar *Edukimi mediatic dhe kultura mediatike*.

Për arritjen e suksesshme të rezultateve nga të nxënësve, të përcaktuara në këtë fushë të programit mësimor, është e nevojshme të realizohen aktivitete cilësore dhe krijuese gjatë orëve mësimore, përmes të cilave nxënësit do të edukohen dhe do të mësojnë për mediat dhe rolin e tyre.

Doracaku për mësimdhënësit që realizojnë mësim në lëndët gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake do tu ndihmojë mësimdhënësve të grupit klasor dhe lëndor gjatë planifikimit dhe realizimit të orëve mësimore, gjatë së cilave përpunohen përmbajtjet për edukim mediatic dhe kulturë mediatike. Doracaku është përgatitur të jetë një mbështetje dhe frymëzim në punën e mësimdhënësve për realizim të suksesshëm dhe realizim kreativ të mësimdhënies.

Çdo shembull për realizimin e aktiviteteve të orëve mësimore i referohet përmbajtjes specifike që lidhet me standardet përkatëse për vlerësim nga programi mësimor që duhet të arrihet përmes aktiviteteve gjatë prës mësimore. Gjithashtu janë shënuar edhe pajisjet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve gjatë orës mësimore.

Shembujt e orëve janë zhvilluar përmes aktiviteteve për pjesën hyrëse, për pjesën kryesore dhe për pjesën përfundimtare të orës. Qëllimi i aktiviteteve hyrëse është të aktivizojë para njohuritë e nxënësve dhe t'i prezantojë ata me përmbajtjen. Zakonisht konceptohen përmes hulumtimeve ose diskutimeve të shkurta për të shpjeguar ose "paralajmëruar" konceptet që do të përpunohen gjatë orës. Në pjesën që ka të bëjë me aktivitetet nga pjesa kryesore e orës mësimore, jepet një përshkrim i detajuar i aktivitetit/aktiviteteve përmes të cilave nxënësit do të eksplorojnë dhe mësojnë përmes përvijës, si dhe një propozim për mënyrën e organizimit të punës së nxënësve në grupe ose në çifte. Aktivitetet kryesore për orët mësimore në Doracak, ofrojnë një gamë të gjerë idesh për mësim dhe për veprim krijues. Aktivitetet përfundimtare, nga ana tjetër, kanë për qëllim nxjerrjen e konkluzioneve përmes diskutimeve. Pjesa e fundit e shembujve për orët mësimore, paraqet reflektim në të cilin ofrohen pyetje në lidhje me atë që nxënësit kanë mësuar, duke përmbledhur dhe lidhur atë që kanë mësuar me jetën e tyre të përditshme.

Mësimdhënësit mund t'i përdorin shembujt për realizimin e orëve për edukim mediatik nga doracaku si ide për aktivitete përmes të cilave do të arrijnë standardet për vlerësim në realizimin e përmbajtjes së mësimore të programi mësimor për gjuhë maqedonase, shqipe, turke, serbe dhe boshnjake. Aktivitetet mund të ndërmerren siç janë dhënë, mund të përshtaten ose modifikohen, përkatësisht të ndryshohen në përputhje me idetë e mësuesit, nevojat dhe interesat e nxënësve dhe përparimin e tyre në procesin mësimor, mjetet e punës në dispozicion, kushtet në shkollë, etj. Ato paraqesin shembuj të të mësuarit kreativ dhe eksperimental për edukim mediatik sipas programeve mësimore të reja. Bazuar në këto shembuj, mësuesit mund të zhvillojnë lehtësisht skenarë për realizimin e orëve mësimore, në varësi të mjedisit dhe kushteve në të cilat ata realizojnë mësimin. Përveç kësaj, mësimdhënia e integruar mundëson që disa nga standardet dhe aktivitetet për arritjen e tyre të lidhen me përmbajtje të ngjashme ose të përafërta, që janë parashikuar në lëndë të tjera.

Pritet që ky manual të jetë jo vetëm një mbështetje për mësuesit në planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies, por gjithashtu të jetë një nxitje për kreativitet, motivim dhe entuziazëm edhe më të madh gjatë punës.

KLASA III

EDUKIMI MEDIATIK DHE KULTURA MEDIATIKE

Sipas programit mësimor Gjuha Shqipe për klasën e tretë, në kapitullin e Edukimit Mediatik dhe Kulturës Mediatike mësohen si vijon:

Përmbajtja (dhe kuptimi)

- Ndikimi i mediave (informacione problematike dhe edukative, përmbajtje manipuluese)
- Përdorimi i telefonit celular (pajisje e mençur, aplikacione për telefon/ pajisje e mençur, ikona, emotikonë)
- Kërkim në internet (linqe, fjalë kyç, google)
- Krijimi i përmbajtjeve të thjeshta mediatike

Në fund të vitit shkollor, për këtë kapitull nxënësit duhet të arrijnë si vijon:

Rezultate nga mësimi

Nxënësi/nxënësja do të aftësohet:

1. Të japë shembuj për të shpjeguar/përshkruar se si mediat ndikojnë ndaj përdoruesve;
2. Të shpjegojë se si në mënyrë të sigurt përdoret telefoni celular për qasje deri te informacionet përmes aplikacioneve;
3. Të kërkojë dhe të gjejë informacione të nevojshme në internet përmes përdorimit të fjalëve kyç;
4. Të krijojë përmbajtje të thjeshta mediatike me lidhjen e tekstit dhe ilustrimeve.

Nxënësi/nxënësja do të krijojë vetëdije për:

1. Ndikimin e edukimit mediatik dhe digjital në jetën e përditshme;
2. Përdorimin e sigurt të pajisjeve digjitale dhe aplikacioneve për qëllime të dobishme.

Lista e temave nga fusha e Edukimit Mediatik¹

Reklamë ↘ Prezantim publik i prodhimit, shërbimit ose veprimtarisë, me ç'rast theksohen cilësitë e prodhimit të reklamuar me qëllim që të tërhiqet vëmendja e konsumatorëve dhe të nxitet furnizimi/blerja. Prezantimi mund të jetë në formë të fotografisë dhe tekstit, me video ose në formë audio.

Internet ↘ Rrjet botëror kompjuterik i lidhjes elektronike, i cili u mundëson shfrytëzuesve që në kompjuterët personalë dhe në pajisjet e tjera kompjuterike, që gjenden në cilëndo pikë në Tokë, të kenë lidhje me njëri tjetrin, të marrin dhe të këmbëjnë informacion tekstual, audio dhe vizual.

Aplikacion ↘ Program kompjuterik ose soufterik, i cili kryen një detyrë të caktuar, ose përmbledhje detyrash. Mund të shfrytëzohet në pajisje të ndryshme digjitale.

Kërkues ↘ Sisteme të specializuara soufterike për kërkimin e përmbajtjeve në internet. Kërkimi bëhet përmes tekstit ose përmbajtjes vizuale (fotografi, pamje). Rezultatet e kërkimit tregohen në format të listës së lidhjeve (linqeve) të renditura sipas numrit të vizitorëve në linkun e dhënë.

Fjalë kyç ↘ Fjalë, term ose frazë që janë të rëndësishme/thelbësore për kuptimin e ndonjë teksti, porosie ose përmbajtjeje tjetër.

Burim i informacioneve ↘ Dikush ose diçka që jep informacione në kohën e duhur, të cilat gazetarët i shfrytëzojnë për kompletimin e lajmeve. Person, dokument, publikim ose shkresë tjetër, e përgatitur nga ndonjë institucion shtetëror ose organizatë. Mund të jenë fizike dhe humane. Burime fizike janë: komunikatat, dokumentet, buletinet, raportet, pjesë nga gazetatat, letra, dosje, libra, video etj. Burime humane janë: persona zyrtarë, politikanë, zëdhënës, gjykatës, policë, përfaqësues sindikalë, përfaqësues të kompanive dhe organizatave, dëshmitarë të krim-it, fatkeqësive ose njerëz pjesëmarrës në ngjarje të tjera.

Burimet mund të jenë primare dhe sekondare. Primare janë ato që e kanë informacionin e dorës së parë. Ato mund të jenë pjesëmarrës në ngjarje, viktime ose dëshmitarë.

¹ Numri më i madh i termave në këtë Listë të temave janë në harmonizim me Fjalorin e Edukimit Mediatik, të cilin e përgatiti Instituti i Studimeve të Komunikimit (2023), si dhe në "Doracakun për trajnues për Edukimin Mediatik: Mësojmë që të dallojmë", i përgatitur në kuadër të Projektit të USAID-it për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë".

**DORACAK PËR
REALIZIMIN E MËSIMIT
NË GJUHËN SHQIPE**

NË FUSHËN E EDUKIMIT MEDIATIK

NË KLASËN III



NDIKIMI I MEDIAVE

(3 orë)



Ora mësimore 1

Ndikimi i mediave - informacione problematike dhe edukative

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- bën dallimin midis informacioneve problematike dhe edukative me përmbajtjet mediatike.

Burime për orën:

- Tabela (ose tabela inteligjente);
- markerë;
- letra;
- ilustrime;
- qasje në internet;
- kartonë me ngjyrë;
- film.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

*Çfarë mund të mësohet nga filmat vizatimorë?
(realizimi 10 minuta)*

Nxënësit ndjekin inserte/ilustrime nga filmi vizatimor "Tomi dhe Xheri" (Shembulli 1) dhe shpjegojnë:

- Çfarë është paraqitur në secilën prej tyre?

Nxënësit diskutojnë se cilat nga ilustrimet e prezantuara paraqesin situata edukative, ndërsa cilat janë problematike.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Informacione edukative dhe problematike si dhe situata (realizimi 20 minuta)

- Mësimdhënësi i pyet nxënësit:

- Cilat filma të tjerë vizatimorë i ndjekni ?

- A mund të kujtoni dhe të ndani ndonjë situatë edukative nga ndonjë film vizatimor?

A mund të kujtoni ndonjë situatë problematike nga ndonjë film vizatimor?

Nxënësit, të ndarë në grupe, diskutojnë për filmat vizatimorë që ndjekin dhe përgjigjen në pyetjet e mësimdhënësit. Në bazë të përgjigjeve duhet të theksohen disa shembuj për sjellje të mirë dhe të keqe (situatë edukative/informacion) të cilat i kanë vërejtur në filmin vizatimor (për shembull, shoqërim, ndihmë, respektim etj.) dhe disa shembuj të sjelljes së pahijshme (situatë problematike /informacion) të cilat i kanë vërejtur në filmin vizatimor (për shembull, rrahje, shtyrje, dinakëri). Një nxënës nga secili grup i prezanton përgjigjet.

Gjatë prezantimit të secilit grup, mësimdhënësi ndan një-dy shembuj, vëren/shpërndan situata/informacione në tabelë në formë të T-tabelës (Shembulli 1).

Në bazë të informacioneve të paraqitura në T-tabelë, me nxënësit diskutohet:

- Kur informacionet e dhëna konsiderohen si problematike, ndërsa kur janë edukative?

↘ Cilat do të ishin pasojat nëse situatat e njëjta ndodhin në realitet?

Më pas nxënësit diskutojnë:

↘ A ishte lehtë të vërehet se cila situatë/përmbajtje mediatike është edukative, përkatësisht problematike?

↘ Cilat informacione kanë ndihmuar në identifikimin e llojeve të informacioneve (edukative ose problematike) dhe cilat informacione kanë qenë thelbësore për përcaktimin?

↘ Si ndikojnë informacionet edukative ndaj tyre, dhe si ndikojnë ato problematike?

Në fund, bashkërisht konstatojnë se një nga rolet e mediave është të edukojnë, përkatësisht të na mësojnë për çështje të ndryshme. Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme t'i kuptojnë përmbajtjet edukative dhe problematike, të bëhet dallimi midis sjelljes dhe veprimit të personazheve në filma dhe sjelljes së njerëzve në jetën e përditshme.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1

Aktiviteti

Ndarja (realizimi 10 minuta)

Tregohen përmbajtje mediatike edukative dhe problematike (Shembulli 2) ndërsa nga nxënësit kërkohet të tregojnë kartonin e gjelbër ose të kuq (të gjelbër nëse është edukativ, të kuq nëse është problematik) dhe të arsyetojnë se përse mendojnë ashtu.

Më pas përgjigjen në pyetjet e parashtruara:

↘ Si mund të ndikojë në realitet situata problematike e paraqitur në film nëse ndaj saj nuk ka qasje kritike?

↘ Si mund të ndikojë në realitet, informacioni edukativ i paraqitur në film?



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mund atë që mësuat ta shfrytëzoni në jetën e përditshme?

1 Shembulli

T-tabela

Sjellje e hijshme – Situatë/informacion edukativ	Sjellje e pahijshme – Situatë/informacion problematik

12

2 Shembul

Përbajtje mediatike (pjesë të marra nga filmat vizatimorë, stripe, reklama)

Reklamë e Krishtlindjes (reklamë video): <https://www.fakulteti.mk/news/12112020/dizni-objavi-emosivna-bozhikjna-reklama-za-humanitarni-celi>

“Tomi dhe Xheri” (film vizatimor): <https://www.youtube.com/watch?v=NL1EymyDMnI>

“Borëbardha dhe shtatë xhuxhat” (afishe):

https://www.google.com/search?q=snowwhite&tbn=isch&chips=q:snowwhite,online_chips:dwarfs+1937:EX1g47p2XAM%3D&hl=mk&sa=X&ved=2ahUKEwj9x67SoI-AAxXZhaQKHSeECCkQ4lYoA3oECAEQLg&biw=1903&bih=892#imgrc=liFCCw1EjX5VEM

“Tregimet e Bibit” (film vizatimor): <https://www.youtube.com/watch?v=VDKkbbJBgUU>

Ora mësimore 2

Ndikimi i mediave ndaj emocioneve të përdoruesve

Standardi i vlerësimit

Nxënësit/nxënësja:

- Shpjegon (përmes shembujve) se si përmbajtjet e mediave ndikojnë ndaj emocioneve të përdoruesve.

Burime për orët:

- tabelë (ose tabelë inteligjente);
- markerë;
- ngjyra;
- letra;
- letër e madhe me ilustrim të ngjitur;
- qasje në internet;
- karta me rrëfime të papërfunduara.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Qëlllo se si ndihem (realizimi 10 minuta)

Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grup merr nga një letër të madhe me ilustrim të ngjitur në mes. Në çdo ilustrim është vendosur nga një emocion: lumturi, hidhërim, frikë, pikëllim, refuzim, mahnitje (Shembulli 1). Nxënësit, në çdo grup së bashku, mendojnë situata/ngjarje konkrete të cilat mund ta shkaktojnë këtë emocion dhe idetë i shkruajnë në hapësirën e zbrazët rreth ilustrimit (për shembull, lumturi – biçikletë e re, akullore; frikë – errësirë, bubullima).

Një përfaqësues i çdo grupi prezanton emocionin para grupeve të tjera, duke i renditur shembujt të cilat do të mund ta shkaktinin këtë emocion.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përmbajtjet mediatike shkaktajnë emocione (realizimi 20 minuta)

Nxënësit shohin disa ilustrime me emocione (për shembull, një fëmijë që qan pasi ka humbur kafshën shtëpiake, fëmijë i humbur në pyll, fëmijë që fryn qiriun e ditëlindjes, fëmijë që përqafohet me prindërit – Shembulli 2), dhe për çdo pamje/ilustrim tregojnë se cilat emocione janë të paraqitura. Nxënësit së bashku me mësimdhënësit diskutojnë për atë se çfarë shkaktajnë emocionet te njerëzit, si i nxisin të sillen dhe çfarë të bëjnë.

Çdo grup tërheq nga një letër në të cilën është i shkruar një emocion (për shembull, lumturi, pikëllim, frikë, mahnitje). Detyrë e tyre është që tregojnë përmbajtje mediatike (film vizatimor, film, seri për fëmijë, këngë, videoklip) e cila ka shkaktuar një emocion të tillë te ta. Pasi të gjitha grupet të ndajnë përvojat e tyre, përmes diskutimit të hapur konkludohet se më shumë përmbajtje mediatike janë krijuar për të shkaktuar emocione te përdoruesit. Në këtë mënyrë nxisin interesim te publiku, që është dhe një ndër arsyet se përse njerëzit duan të shohin televizion ose video në internet.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Ushtrim – Tregime të pambaruara (realizimi 10 minuta)

Nxënësit punojnë në dyshe. Secili çift tërheq kartën me rrëfime të pambaruara (Shembulli 3). Rrëfimin nga karta e kompletojnë dy nxënësit, duke dhënë shembuj kur një përmbajtje mediatike ka ndikuar ndaj emocioneve të tyre dhe si. Si shtesë, çdo dyshe e nxënësve mund të bëjë vizatim dhe ta ilustrojë emocionin që është në kartë.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Ku do t'ju shërbejë në jetën e përditshme?

1 Shembulli

Emocione



Lumturi



Hidhërim (mLlef)



Frikë



Pikëllim



Neveri



Mahnitje

2 Shembulli

Ilustrime me emocione të shprehura

1. Fëmijë që qan pas humbjes së kafshës shtëpiake²



2. Fëmijë i humbur në pyll³



3. Fëmijë që fryn qiriun e ditëlindjes⁴



4. Fëmijë që përqafohen me prindërit⁵



2 Burimi: https://www.freepik.com/free-photo/small-kid-playing-hide-peek-closing-her-eyes_10741019.htm#query=kid%20crying&position=3&from_view=search&track=ais

3 Burimi: https://www.freepik.com/free-photo/boy-lost-sad-forest_19086616.htm#query=lost%20in%20the%20wood&position=22&from_view=search&track=ais

4 Burimi: https://www.freepik.com/free-photo/beautiful-girl-blowing-candles-cake_1957417.htm#query=kid%20blowing%20candles&position=4&from_view=search&track=ais

5 Burimi: https://www.freepik.com/free-photo/happy-team-hugging-field_9590418.htm#query=kid%20hugging%20parents&position=4&from_view=search&track=ais

3 Shembulli

Kartë me tregime të papërfunduara

Ndihem i/e lumtur kur:

(Plotëso)

Shembull: Shoh emision për
pushimin veror

Ndjehem i/e hidhëruar kur:

Plotëso...

Ndihem i/e emocionuar kur:

Plotëso...

Ndihem i/e frikësuar kur:

Plotëso...

Ndihem i/e pikëlluar kur:

Plotëso...

Ndihem i/e vetmuar kur:

Plotëso...

Ndihem i/e relaksuar kur:

Plotëso...

Orë mësimore 3

Ndikimi i mediave - Përmbajtje manipuluese në media

Standardi për vlerësim

Nxënësi/nxënësja:

- Gjen përmbajtje manipuluese në media.

Burime për orën:

- Tabelë (ose tabelë inteligjente);
- Figura ngjytëse;
- Markerë;
- Ngjyra;
- Letra;
- Qasje në internet;
- Ilustrime nga reklama.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

E saktë – e pasaktë (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi ua tregon disa fotografi nxënësve (disa prej të cilave janë ndryshuar me fotoshop), ndërsa detyrë e nxënësve është të tregojnë se cilat fotografi janë të vërteta, ndërsa cilat janë ndryshuar me ndihmën e programeve kompjuterike (Shembulli 1). Përmes diskutimit duhet të tregohet se cilat fotografi janë të vërteta, ndërsa cilat nuk janë dhe të shpjegojnë se përse mendojnë ashtu.


Mësimdhënësi shpjegon se ndonjëherë krijohen informacione, video dhe fotografi, të cilat janë të rreme ose gjysmë të sakta. I nxit nxënësit të mendojnë se cilat mund të jenë arsyet për këtë. Së bashku konkludojnë se arsyet mund të jenë të ndryshme: ndonjëherë bëhet fjalë vetëm për shaka, por ndonjëherë qëllimi i gënjeshtërës është krejt ndryshe. Për shembull, arsyeja mund të jetë që më shumë njerëz ta shohin fotografinë ose videon, të ndryshojë mendimi i dikujt, ndërsa ndonjëherë edhe të shkaktojë dëm ndaj dikujt.

Në fund bashkërisht konstatojnë se nuk mund gjithmonë të vërehet dallimi dhe të kuptohet përmbajtja e vërtetë dhe e rreme.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Telefoni i prishur (realizimi 20 minuta)



Nxënësit qëndrojnë në rreth dhe e luajnë lojën "telefoni i prishur". Mësimdhënësi/mësimdhënësja u jep instruksione dhe udhëzime se si luhet loja. Loja fillon me atë që mësimdhënësi i pëshpërit nxënësit të parë një fjali

paraprakisht të përgatitur që përmban informacion të caktuar. Fjalja është e shkruar në letër. Nxënësi duhet ta përcjellë fjalinë me pëshpëritje të shoku afër tij dhe kështu me radhë. Nxënësi i fundit duhet ta thotë fjalinë me zë. Në mënyrë shtesë, një nxënës merr detyrë të "fshehtë" që të ndryshojë, shtojë ose të heq ndonjë fjalë nga fjalja.

Shembull për fjalinë që mund të shfrytëzohet në lojë:

Arbeni e mori një gotë me ujë, gota i ra dhe u thye. ("detyrë e fshehtë": fjala 'mori' zëvendësohet me fjalën 'piu')

Rregull i rëndësishëm është që në fillim të këtij aktiviteti të theksohet se fjalja duhet të shqiptohet në mënyrë të qartë, por megjithatë me pëshpëritje që të mos mund ta dëgjojë askush tjetër përveç nxënësit të cilit i pëshpëritet, ndërsa ai/ajo duhet të tentojë që ta dëgjojë mirë fjalinë me qëllim që të mund t'ia përcjellë më tej nxënësit që është i ulur afër tij. Në fund bëhet krahasimi midis fjalisë së shkruar dhe fjalisë të cilën e nxënësi e tha i fundit. Nxënësit verifikojnë nëse ka ndryshim në përmbajtjen e fjalisë. Gjatë diskutimit për përmbajtjen e fjalisë u tregohet nxënësve se njëri nga ata qëllimisht e ka ndryshuar një fjalë.

Nxënësit diskutojnë për përshtypjet pas lojës dhe përgjigjen në pyetjet të cilat i parashtron mësimitdhënësi:

- Si ishte fjalja në fillim, ndërsa si ishte në fund?
- Cilat janë arsyet e ndërrimit të përmbajtjes së fjalisë?
- Cilat janë arsyet për të cilat njerëzit mund t'i ndërrojnë porositë?
- A mund që dikush këtë ta bëjë qëllimisht?
- Kjo a mund të ndodh edhe në jetën e përditshme?
- A mund gjithmonë të besojmë në diçka që të tjerët e kanë rrëfyer ose shkruar?
- Si mund të verifikohet nëse është e vërtetë ajo që do ta dëgjojmë ose lexojmë?

Nxënësit dhe mësimitdhënësi konkludojnë se shpesh në përditshmëri kur përcillen porositë nga njëri te personi tjetër, porosia mund të ndryshojë pak ose në mënyrë të theksuar. Arsyet se përse ndodh kjo, mund të jenë sepse porosia fillestare është gabuar pa qëllim. Ndoshta nuk është thënë mirë, nuk është përcjellë ose nuk është dëgjuar mirë. Nga ana tjetër, ndonjëherë ndodh që edhe personi që e përcjellë qëllimisht ose pa qëllim të shtojë diçka në porosi, të theksojë ndonjë pjesë ose të heq pjesë tjetër nga ajo. Ndonjëherë disa njerëz qëllimisht krijojnë dhe shpërndajnë edhe informacione tërësisht të pavërteta me qëllim që të bindin dikë në diçka, të ndikojnë ndaj mendimit të tij ose të dëmtojnë dikë.

Nxënësit dhe mësimitdhënësi konkludojnë se porositë e përcjella duhet të kontrollohen me burimin e informacionit, sepse ndoshta kanë ndryshuar gjatë përcjelljes.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shembuj me reklama (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi paraqet shembull nga reklama për ndonjë prodhim⁶ dhe përmes diskutimit arrihet në konkludimin se përmbajtjet mediatike shumë shpesh krijohen në mënyrë që theksohen vetëm disa karakteristika të bukura dhe pozitive për atë që reklamohet.

Nxënësit në dyshe shkruajnë nga një reklamë në figura ngjyëse me ngjyrë (mund të jetë e lidhur me vitamina që japin fuqi, me ushqim për fëmijë ose me pije). Nxënësit duhet ta kontrollojnë përmbajtjen e prodhimit që reklamohet me qëllim që të përcaktojnë nëse ai vërtet është i mirë, i shëndetshëm për fëmijët ashtu siç theksohet në reklamë. Nxënësit duhet të përgjigjen:

- A thua vallë reklama për prodhimin konkret tregon saktë ose në mënyrë të pasaktë karakteristikat e prodhimit?
- A mungon diçka ose nuk është treguar në shpjegim?
- Cili informacion është i rëndësishëm për shëndetin tonë, ndërsa nuk është në reklamë ?



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë nga aktivitetet në orë?
- Si mund ta shfrytëzoni atë që mësuat në jetën e përditshme?

⁶ Për shembull, reklama për «koka kolën»: <https://www.youtube.com/watch?v=i04jiuaM6uw>

1 Shembulli

E saktë ose e pasaktë

Cila nga këto fotografi është e vërtetë, ndërsa cila jo?

Shembulli 1



Përgjigje: Fotografia e parë nuk është e vërtetë dhe është bërë më ndihmën e fotoshopit.

Shembulli 2





Përgjigje: Fotografia e tretë është e vërtetë, ndërsa dy të parat janë ndryshuar me ndihmën e aplikacioneve kompjuterike.

Shembulli 3



Përgjigje: Të dyja fotografitë janë të vërteta. Biçikleta në pemë gjendet në ishullin Uashon në Uashington. Sipas njëres prej legjendave, një djalë e ka lënë biçikletën në vitin 1950 dhe është larguar përgjithmonë nga ishulli. Koshi në degë, ndërkohë, gjendet në afërsi të Kriva Pallankës në Maqedoni.

Shembulli 4



Përgjigje: Fotografia e parë është ndryshuar, ndërsa maces i janë vendosur vetulla të bardha. Macja me të vërtetë ka mustaqe të bardha.

22

Shembulli 5



Përgjigje: Fotografia e parë është ndryshuar me ndihmën e aplikacioneve kompjuterike.

Ora mësimore 4

Ndikimi i mediave - Përmbajtje manipuluese në media

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- Vëren përmbajtje manipuluese në media.

Burime për orën:

- tabela (apo tabela e mençur);
- figura ngjitëse;
- markerë;
- ngjyra;
- letra;
- qasje në internet;
- karton.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktivitet

Reklama të fshehta në videot në Jutjub (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi dhe nxënësit ndjekin një pjesë të videos në Jutjub, faqen e njohur "Bota e Rajanit", e cila ka më shumë se 35 milionë shikues.⁷ Pas disa minutave nga videoja, mësimdhënësi hap diskutim për pyetjet si vijon:

- Kush e ka bërë këtë video?
- Përse e ka bërë? (Përgjigje të mundshme: për të na argëtuar, për të na treguar disa lojëra.)
- A ju pëlqejnë lojërat të cilat i paraqet Rajani? A do të dëshironit që edhe ju të keni ndonjërin prej tyre?

Pasi nxënësit të ndajnë përshtypjet e tyre për videon, mësimdhënësi shpjegon se kjo, në fakt, në mënyrë të fshehtë reklamon ndonjë prodhim. Ai u shpjegon fëmijëve se familja e Rajanit përfiton shumë nga reklamimi në Jutjub, ndërsa pjesën më të madhe përmes reklamimit të fshehtë të lojërave dhe prodhimeve të tjera të ndryshme. Për këtë qëllim, ua bën me dije nxënësve që herën tjetër kur të shohin diçka në Jutjub, të mendojnë kush e bën dhe cila është arsyeja e videos – vallë vetëm për të na argëtuar ose ndoshta në mënyrë dinake për të na bindur të blejmë diçka.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Donci dhe Banci (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi në tabelë vendos dy vizatime/ilustrime: njëri me emotikon të buzëqeshur, ndërsa tjetri me emotikon të pikëlluar (Shembulli 1). Nxënësit ndahen në katër grupe. Dy nga grupet marrin letër me tekstin si vijon:

"Në një planet kanë jetuar Banci dhe Donci. Bancët kanë qenë të mençur, punëtorë, mikpritës dhe gjithmonë të disponuar. Për dallim nga ta, Doncët kanë qenë përtacë, xhelozë, agresivë dhe gjithmonë të mrrolur."

Dy grupet e tjera marrin një tekst me përmbajtjen si vijon:
Në kuadër të secilit grup, nxënësit merren vesh se cili vizatim në tabelë tregon disponimin e Doncëve dhe Bancëve.

⁷ Burimi: <https://www.youtube.com/watch?v=78UKGeLWZ0M>

Mësimdhënësi pyet se cili emotikon nxënësit e lidhin me Bancët, ndërsa cilin emotikon me Doncët. Grupet konkludojnë se ka dallime, pas çka çdo grup zëshëm e lexon tekstin që ka marrë. Hapet diskutim për pyetjet si vijon:

- Autori i cili e ka shkruar tekstin për të buzëqeshurit Banci dhe të mrrolurit Donci, është Banc ose Donc?
- Çfarë mendoni – a kanë qenë të disponuar pozitivisht Bancët ose Doncët? Nga kush varej kjo?
- Çfarë do të ndodhte nëse xhiroj film për Doncët dhe për Bancët, i inspiruar nga njëri prej versioneve, pa e ditur versionin tjetër?
- Kush do të jetë më simpatik për shikuesit – Doncët ose Bancët?

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Kush e dërgon këtë porosi? (realizimi 10 minuta)

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, përkatësisht e dëgjojnë tekstin të cilin e lexon mësimdhënësi:

“Në qendrën tonë tregtare sot do të mbërrijë një nga futbollistët më të njohur të ditëve të sotme. Shkronjat e para të emrit dhe mbiemrit të tij janë: L.M. Dhjetë të parët që do të dërgojnë porosi në numrin e telefonit 077 45643210, do të kenë mundësi të shoqërohen me futbollistin nesër në trajnimin e tij në fushën tonë.”

Pas leximit, hapet diskutimi për pyetjet si vijon:

- Çfarë mendoni, kush e ka dërguar porosinë?
- A ka informacion në porosi se kush e organizon ngjarjen?
- A ka informacion për kohën e saktë dhe vendin e trajnimit?
- A do të dërgoni porosi? Shpjegoni përgjigjen tuaj.

Nxënësit konkludojnë se bëhet fjalë për përmbajtje manipuluese, sepse nuk ka informacion për organizatorin e ngjarjes, nuk ka orë të saktë dhe vendtakim të caktuar, ndërsa informacioni nuk mund të gjendet në media të tjera.




Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga aktivitetet në orë?
- Si mund atë që e mësuam ta shfrytëzojmë në jetën e përditshme?

PËRDORIMI I TELEFONIT CELULAR

(4 orë)



Ora mësimore 1

Përdorimi i telefonave celularë në mënyrë të sigurt

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- Tregon aplikacionet në telefonin celular/pajisjen e mençur që janë të dobishme dhe të sigurta për shfrytëzim.

Burime për orën :

- Tabela (ose tabela e mençur);
- ngjyra;
- markerë;
- letra;
- qasje në internet;
- telefon i mençur;
- gërshërë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përse telefonin e mençur e quajmë "të mençur" (inteligjent)? (realizimi 10 minuta)

Ora fillon në atë mënyrë që mësimdhënësi simulon zile telefoni dhe demonstroi shembull pozitiv të bisedës telefonike me bashkëbiseduesin (për shembull, me koleg, me drejtorin e shkollës, me prindin e ndonjërit prej nxënësve etj.).

Më pas mësimdhënësi fillon bisedën me nxënësit për qëllimin e telefonit dhe parashtron pyetje, si për shembull:

- A e dini se përse shërben telefoni celular?
- A e shfrytëzoni në jetën e përditshme për të biseduar me prindërit tuaj dhe me shokët? Sa gjatë bisedoni në telefon?
- Cilat fjalë i përdorni, ndërsa kanë të bëjnë me përdorimin në mënyrë të kulturuar dhe racionale të telefonit?
- Për çfarë tjetër e shfrytëzoni telefonin e mençur?

Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se ekzistojnë rregulla të caktuara për shfrytëzim të kulturuar dhe racionale të telefonit gjatë bisedave, me ç'rast e shfrytëzojnë shembullin personal pozitiv nga fillimi i orës.

Qëllimi i këtij aktiviteti është që nxënësit të mësojnë se roli parësor i telefonit është vendosja dhe ruajtja e komunikimit. Megjithatë, me paraqitjen e telefonave të mençur, ato mund të shfrytëzohen edhe për kërkimin e informacioneve, kërkimin e të dhënave, për dëgjimin e muzikës, për fotografim, si dhe për krijimin e përmbajtjeve personale. Telefonat e mençur përmbajnë të ashtuquajtura aplikacione, të cilat i mundësojnë të gjitha këto funksione.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Telefonat e mençur dhe aplikacione të dobishme (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi fillon diskutimin me nxënësit:

- Përse telefonat e sotëm celularë quhen telefona të mençur? (Përgjigje e pritur: përveç që mundësojnë biseda telefonike, mund edhe të përcjellin informacione që përmbajnë pamje, video, tekste).
- Cilat pajisje të tjera janë të mençura? (Përgjigje e pritur: tabletë, orë).

Nxënësit, të ndarë në tri grupe (varësisht nga numri i telefonave të mençur ose orëve të cilat mësimdhënësi do të lejojë të shfrytëzohen), marrin detyrë që t'i gjejnë aplikacionet në telefonat celularë (që janë në telefona dhe të cilat nuk duhet të instalohen në mënyrë shtesë). Përmes këtyre aplikacioneve mund të lexojnë sa është ora, të bisedojnë në telefon, të dërgojnë dhe të pranojnë porosi, të fotoqafojnë dhe xhirojnë si dhe t'i ruajnë fotografitë/xhirimet e bëra, të shfrytëzojnë kalendarin, ta ndjekin aktivitetin e tyre fizik, të dëgjojnë muzikë dhe të shohin videoxhirime dhe të luajnë videolujëra. Grupet (në mënyrë alternative) i prezantojnë ikonat para bashkëmoshatarëve të tyre. E përshkruajnë pamjen e ikonës dhe qëllimin e vetë aplikacionit.

Në fund, përmes diskutimit konstatohet se telefonat e mençur, përveç për komunikim, përbajnë aplikacione të ndryshme të cilat na lehtësojnë jetën: na tregojnë sa është ora, si do të jetë moti, na mundësojnë të dëgjojmë muzikë ose të fotoqafohemi.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Aplikacione të sigurta për telefonat e mençur (realizimi 10 minuta)

Çdo nxënës merr letër mësimore me vizatim të telefonit të mençur (Shembulli 2) dhe letër mësimore me vizatime të ikonave të aplikacioneve që shfrytëzohen në telefonat celularë (Shembulli 1). Nxënësit marrin si detyrë që t'i ngjyrosin ikonat, t'i presin dhe t'i ngjisin aplikacionet në vizatimin e tyre me telefon të mençur. Çdo nxënës prezanton dhe tregon qëllimin e aplikacionit. Punimet vendosen në mur ose në tabelë.



Reflektim


- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga aktivitetet në orë?
- Si mund ta shfrytëzojmë atë që e mësuam në jetën e përditshme?

1 Shembulli

Aplikacione që shfrytëzohen në telefonat e mençur për komunikim, për mësim dhe për argëtim



Gugëll




Jutjub




Kalendari



Telefon



E-mail (imejl)



Snepçet




Porosi



Harta Gugëll

2 Shembulli

Ilustrim i telefonit të mençur



Ora mësimore 2

Përdorimi i telefonit celular - sjellja e përgjegjshme dhe e papërgjegjshme

Standardi e vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- e shpjegon (përmes shembullit) dallimin midis sjelljes së përgjegjshme dhe të papërgjegjshme të përdorimit të telefonit celular
- e shpjegon (përmes shembullit) pse pasvordi i telefonit nuk duhet të ndahet me të tjerët.

Burime për orën:

- tabelë (ose tabelë inteligjente)
- markerë
- ngjyra
- fletë letre
- qasje në internet
- telefona të mençur.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Mosshpërndarja e pasvordit të telefonit (realizimi 10 minuta)

Nxënësve iu prezantohet situatë, në të cilën është keqpërdorur një telefon i huaj celular për dërgimin e porosive jo të përshtatshme. Mësimdhënësi ofron shembull të një situatë të supozuar: shokët kërkuar nga Agroni që t'ua tregojë pasvordin e telefonit të tij celular. Agroni nuk ka dashur t'ua thotë pasvordin, por pasi i kanë premtuar se nuk do ta keqpërdorin, ai ua ka treguar. Rrugës nga shkolla deri në shtëpi, ia kanë kërkuar telefonin. Agroni ua ka dhënë pa dyshuar se do të keqpërdoret telefoni i tij për dërgimin e porosive të pakëndshme personave të tjerë.

Nxënësit, të ndarë në grupe, përgjigjen në pyetjet:

- Pse Agroni ua ka dhënë pasvordin shokëve?
- Si shokët e kanë dëmtuar Agronin?
- A dini për ndonjë shembull të ngjashëm?
- A ju ka ndodhur ndonjë gjë e ngjashme juve ose shokut tuaj?
- Si është dashur të veprojë Agroni?
- Si është dashur të veprojnë shokët e tij?

Pasi t'i ofrojnë përgjigjet para të gjithëve, përmes diskutimit të përbashkët konkludohet se me zbulimin e pasvordit tuaj (kjo nuk vlen për prindërit, ata gjithsesi se duhet ta dinë pasvordin e fëmijëve të tyre), rrënohet e drejta e privatisë së fëmijës dhe mundësohet keqpërdorimi i telefonit, me çka mund të dëmtohet fëmija, por edhe persona të tjerë. Prandaj, përveç prindërve, pasvordi nuk duhet të ndahet me të tjerët.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përdorimi i përgjegjshëm dhe i papërgjegjshëm i telefonave celularë (realizimi 20 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin Fletën e Punës 1 me situatë të përdorimit të zakonshëm të telefonave celularë, me detyrën që përmes diskutimit në grupe të

identifikojnë cilat përshkrime flasin për përdorim të përgjegjshëm, e cilat për përdorim të papërgjegjshëm. Si shembuj të përshkrimeve mund të shërbejnë situatat në vijim:

- [1]** Gjatë kohës së drekës, Gjergji shkruan dhe lexon porosi në telefonin e tij celular.
(Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme/papërshtatshme)
- [2]** Përderisa mëson, Aleksandri e ruan telefonin e tij nga hapësira e shikimit.
(Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme/përshtatshme)
- [3]** Sanella e përdor telefonin e saj celular që të gjejë informacione, të cilat i duhen që të shkruajë detyrat e shtëpisë.
(Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme/përshtatshme)
- [4]** Anjeza e përdor telefonin e saj celular çdo ditë, për të luajtur videolujtë.
(Përgjigje e pritur: E papërgjegjshme/papërshtatshme)
- [5]** Millani fshehtas shkruan dhe lexon porosi në telefonin e tij celular gjatë orëve të mësimet.
(Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme/papërshtatshme)

Për çdo përshkrim, grupet i prezantojnë përgjigjet e tyre dhe ofrojnë arsyetimet për mendimet e tyre.

Në diskutim, të cilin e moderon mësuesi, konkludohet se telefonat e mençur duhet të përdoren në mënyrë të përgjegjshme. Nxënësit duhet të kuptojnë se telefonat e mençur mund të jenë shkak i sjelljes së papërgjegjshme dhe për krijimin e shprehive, që e dëmtojnë shëndetin, me çka, midis tjerash, ulet aktiviteti fizik dhe koha e shoqërimit të vërtetë.

Pjesa përmblyëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Rregullat për përdorimin e telefonave të mençur (realizimi 10 minuta)

Pasi mësuesi do të tregojë disa shembuj (Shtojca 1), nxënësit duhet vetë të mendojnë "rregulla" për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të telefonave celularë. "Rregullat" që nxënësit i kanë menduar, vendosen në pankartë, e titulluar "Përdore telefonin tënd të mençur në mënyrë të sigurt dhe inteligjente".



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?



Fletë Pune 1 – Shembuj të sjelljes së përgjegjshme dhe të papërgjegjshme

Shënoje me **V** aty ku fëmija sillet në mënyrë të përgjegjshme ose me **X** aty ku sillet në mënyrë të papërgjegjshme:

1. Gjatë kohës së drekës, Filipi mëson dhe shkruan porosi në telefonin celular.
2. Përderisa Enisi mëson, e ruan telefonin celular nga hapësira e të pamurit.
3. Sanella e përdor telefonin e saj celular që të gjejë informacione që i duhen për të shkruar detyrat e shtëpisë.
4. Anjeza e përdor telefonin e saj celular çdo ditë, nga tri ose më shumë orë për të luajtur videolojëra.
5. Arbeni gjatë orëve të mësimit fshehtas shkruan dhe lexon porosi në telefonin e tij celular.

1 Shtojca

Shembull për listë të rregullave – Përdore telefonin tënd të mençur në mënyrë të sigurt dhe të mençur

- ↘ Përdor pasvord për hapje.
- ↘ Vizito faqe të sigurta të internetit.
- ↘ Përdor aplikacione të sigurta.
- ↘ Ruaje privatësinë e telefonit.
- ↘ Respektoje privatësinë e huaj.
- ↘ Mos shpërndaj përmbajtje fyese.
- ↘ Përcakto kohën e përdorimit të telefonit të mençur.

Orë mësimore 3

Përdorimi i telefonave të mençur - Komunikimi i përgjegjshëm dhe i papërgjegjshëm

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- ↘ E shpjegon (përmes shembullit) dallimin midis komunikimit të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm përmes telefonit celular (përveç bisedës ose porosive).

Burime për orën:

- ↘ tabelë (ose tabelë inteligjente);
- ↘ figura ngjyeshme;
- ↘ fletë flipçart;
- ↘ kuti e zbrazët e telefonit të mençur;
- ↘ fletë pune.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përgjegjësitë e mia – detyrimet e mia (realizimi 7-8 minuta)

Përmes teknikës “punë për një minutë” nxënësit marrin detyra që për një minutë të shkruajnë stikerë, për të cilat vetë janë përgjegjës. Për shembull, janë përgjegjës që ta fshijnë tabelën, për ujitjen e luleve, ta ushqejnë dhe ta shëtisin kafshën shtëpiake, përgjegjës janë për detyrat e tyre të shtëpisë, ta rregullojnë shtëpinë e tyre. Nxënësit duke shpërndarë detyrat se kush për çfarë është përgjegjës, bëhen më të vetëdijshëm për rolin e tyre në jetën e përditshme.

Pjesa kryesore e orës mësimore:

1 Aktiviteti

Çfarë është sjellje e përgjegjshme dhe sjellje e papërgjegjshme (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi përgatit fletë me përshkrim të sjelljeve të përgjegjshme dhe të papërgjegjshme. Fletët me përshkrim të sjelljeve janë vënë në kuti, ndërsa çdo fëmijë zgjedh nga një fletë. Mësimdhënësi u jep kohë ta lexojnë përshkrimin e sjelljeve, ndërsa japin mendimin e tyre se si është sjellja e tyre, e përgjegjshme apo e papërgjegjshme.

Shembuj me përshkrim të sjelljeve (Shtojca 1):

- (1)** Ana shkruan komente fyese për të tjerë, kur mendon se e kanë merituar. (Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme)
- (2)** Aneta nuk shpërndan informacione të besueshme për të tjerë përmes porosive. (Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme)
- (3)** Aleksandri nuk e ndien veten fajtor nëse Astritit i ka dërguar porosi që është fyese për Ivanin (Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme)
- (4)** Arta konsideron se mund të shkruajë çfarë të dojë për dikë tjetër, nëse nuk e thekson emrin e tij/saj në porosi. (Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme)
- (5)** Agimi nuk shkruan porosi fyese për të tjerët, edhe atëherë kur mendon se dëshiron të bëjë shaka me ta. (Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme)
- (6)** Hatixhja nuk shkruan në porosi diçka që nuk është përkatëse t’ia thotë dikujt në fytyrë. (Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme)
- (7)** Petari nuk ndan fotografi me shokët që i ka në fotografi. (Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme)

- (8)** Darija i publikon videot e aktiviteteve të garave sportive pa pajtimin e të tjerëve. (Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme)
- (9)** Eva xhiron video së bashku me shokët dhe me pajtimin e tyre i publikon. (Përgjigjja e pritur: E përgjegjshme)
- (10)** Lluka përfshin shokë në biseda grupore në mesinxher pa lejen e tyre. (Përgjigjja e pritur: E papërgjegjshme)

Për çdo përshkrim nxënësi i prezantojnë përgjigjet e tyre, sqarojnë se pse janë përgjigjur në atë mënyrë, ndërsa mësuesi i orienton drejt argumenteve që shpjen drejt përgjigjes së pritur. Në diskutim të hapur konkludohet se shpërndarja e porosive që fyejnë dhe kritikojnë dikë ose përmbajnë informacione të besueshme për dikë paraqet komunikim i papërgjegjshëm, sepse e fyen atë që i dedikohet, pa dallim se porosit do të arrijë deri te ai/ajo ose do ta mësojnë të tjerët, të cilëve nuk u dedikohet.

Pjesa përmblyëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Rregullat për komunikim të përgjegjshëm (realizimi 7-8 minuta)

Në varshmëri nga ajo se sa nxënës kanë/përdorin telefona të mençur, mësuesi i ndan në grupe, prej të cilave njëri grup shtron pyetje, ndërsa të tjerët japin përgjigje.

Shembulli 1:

- ↳ Pyetje: A dëshiron dikush të na tregojë se çfarë kemi pasur detyrë shtëpie?
- ↳ Përgjigje: Në lëndën e Matematikës detyrat në faqen 67, në Gjuhën Shqipe të shkruajmë përgjigjet e pyetjeve për këngën në faqen 23.

Shembulli 2:

- ↳ Pyetje: Hej, a ka dikush numër të Agimit nga klasa tjetër?
- ↳ Përgjigje: Më shkruaj në porosi private, do ta jap.

Si konkluzion nga aktiviteti nxjerrim rregullin e rëndësishëm se duhet të jemi të përgjegjshëm që të respektojmë privatësinë e të tjerëve gjatë çdo komunikimi. Në veçanti është e rëndësishme të bisedohet në mënyrë të kulturuar dhe të përgjegjshme, kur përdoret telefoni celular ose kur bisedohet përmes aplikacionit për komunikim (Viber, Snapçet, Tims).

Konkluzioni shkruhet në hamer dhe theksohet në një vend të dukshëm në klasë.




Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?

1 Shtojca

Shembuj të përshkrimit të sjelljes shembullore dhe joshembullore

- (1)** Ana shkruan komente fyese për të tjerë, kur mendon se e kanë merituar.
- (2)** Aneta nuk shpërndan informacione të besueshme për të tjerë përmes porosive.
- (3)** Aleksandri nuk e ndien veten fajtor nëse Astritit i ka dërguar porosi që është fyese për Ivanin.
- (4)** Arta konsideron se mund të shkruajë çfarë të dojë për dikë tjetër, nëse nuk e thekson emrin e tij/saj në porosi. (Përgjigja e pritur: E papërgjegjshme)
- (5)** Agimi nuk shkruan porosi fyese për të tjerët, edhe atëherë kur mendon se dëshiron të bëjë shaka me ta.
- (6)** Hatixhja nuk shkruan në porosi diçka që nuk është përkatëse t'ia thotë dikujt në fytyrë.
- (7)** Petari nuk ndan fotografi me shokët që i ka në fotografi.
- (8)** Darija i publikon videot e aktiviteteve të garave sportive pa pajtimin e tjerëve.
- (9)** Eva xhiron video së bashku me shokët dhe me pajtimin e tyre i publikon.
- (10)** Lluka përfshin shokë në biseda grupore në mesinxher, pa lejen e tyre.



Orë mësimore 4

Ilustrimi i porosisë tekstuale

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësjë:

- Ilustron porosi tekstuale me emotikon përkatës.

Burimet e orës:

- tabelë (ose tabelë inteligjente);
- fletore;
- fletë me ngjyra;
- gota plastike;
- fletë pune me porosi.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Lojë – Momentet e lumtura, pikëlluese dhe të tjera (realizimi 10 minuta)

Nxënësit përmes aktivitetit “Momentet e lumtura, pikëlluese dhe të tjera” përpunojnë emotikonë. Në fletë të bardha, sipas zgjedhjes së tyre paraqesin fytyrën me emocione të caktuara: i/e lumtur, i/e pikëlluar, i/e nervozuar, i/e menduar, i fuqishëm/ e fuqishme....

Pas vizatimit i ngjyrosin fytyrat, pastaj i presin emotikonët dhe para shokëve të tjerë e tregojnë emotikonin përkatës.

Pastaj mësimdhënësi hap diskutim lidhur me pyetjet në vijim:

- Vallë mundet emotikonët të na ndihmojnë që të shpjegojmë se si ndiehem?
- Vallë i përdorim kur dikujt i shkruajmë diçka ose kur dërgojmë porosi?

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shprehja e emocioneve përmes emotikonëve (realizimi 20 minuta)

Nxënësit, të ndarë në grupe, tërheqin nga një fletë, në të cilën janë të shkruara tri porosi me përmbajtje të ndryshme.

Çdo grup merr porosi të ndryshme, që vënë në pah fatin, gëzimin, kënaqësinë (për shembull, “Kam atlete të reja”), pikëllim (për shembull, “Më vjen keq për macen tënde”), hidhërim (për shembull, “Për shkak teje, mua më qortuan”), dashuri (për shembull, “Të dua shumë”), pajtim, mbështetje (për shembull, “Shkëlqyeshëm e bërë këtë”), brengë (për shembull, “Ende ke temperaturë”?) ose përmbajtje me shaka. Çdo grup i shkruan porositë në fletë ose në tabelë dhe i ilustron me emotikon përkatës, ndërsa pastaj i lexon para nxënësve tjerë.

Përmes diskutimit të përbashkët vërtetohet se cilët emotikonë janë përdorur për ndonjë emocion dhe konkludohet se një emocion i njëjtë mund të shprehet me emotikonë të ndryshëm. Nxënësit së bashku me mësimdhënësin bisedojnë për atë se ndjenjat dhe përjetimet mund të shprehen përmes fjalëve, simboleve, emotikonëve. Nxënësit shpjegojnë se fjalët më saktë dhe në mënyrë më precize i shprehin ndjenjat, përderisa simbolet dhe ilustrimet (emotikonët) mund të kenë një kuptim që e kanë të njohur të gjithë ose të kenë më shumë kuptime.

Megjithatë, emotikonët nuk mund t'i zëvendësojnë fjalët, ndërsa ndonjëherë mund të shpien drejt konfuzionit.

Nxënësit vënë në pah shembuj, kur është është më e përshtatshme që të përdoren emotikonët në vend të fjalëve (për shembull, kur shkruajnë porosi përmes Viberit, kur përdoren rrjetet sociale, kur shkruhen/vizatohen grafite në mure, në reklama ose në situata të ndryshme, kur ka pak hapësirë që të kuptohet porosia me fjalë ose kur porosia duhet të kumtohet me shpejtësi), dhe kur emotikonët nuk guxojnë t'i zëvendësojnë fjalët (për shembull, në letërsi, poezi, tekste mediatike, detyrat shkollore etj.).

Pjesa përmblylëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Programi për hulumtimin e ndjenjave (realizimi 15 minuta)

Nxënësit punojnë në çifte dhe zgjedhin njërin nga emotikonët e ndryshëm, që paraprakisht i ka ndarë mësimdhënësi dhe përmes gjuhës së fytyrës dhe trupit e prezantojnë atë ndjenjë. Çdo çift prezanton para nxënësve tjerë.

Pastaj nxënësit qëndrojnë në rreth. Mësimdhënësi prezanton programin për stërvitje nga tre-katër elementë për ushtrimin e duarve (për shembull, mësimdhënësi është "trajner i fitnesit", ndërsa nxënësit i përsërisin lëvizjet e tij).

Në fillim nxënësit, së bashku me mësimdhënësin/mësimdhënësen komentojnë atë që bëjnë, me qëllim që t'u shpjegohet aktiviteti, ndërsa pastaj imitojnë vetëm lëvizjet pa folur fare.

Në fund të rrethit, disa nga nxënësit vullnetarisht bëjnë "programin" e tyre për disa lëvizje, duke i përdorur shembujt për ndjenja dhe për lëvizje të mundshme, që e ilustron atë ndjenjë.

1. Unë jam i fuqishëm: Qëndroni në tokë me dy shputat e ndara dhe shtrëngojeni muskulin e njëres dorë.
2. Kam frikë: Tërhiqni shpatullat lart. Hapni sytë gjerësisht. Vendosni duart para vetes në qëndrim mbrojtës.
3. Unë jam i guximshëm: Qëndroni në tokë me dy shputat e ndara. Shpina është e drejtë. Vendosni shuplakat në belin tuaj.
4. Unë jam i pikëlluar: Qëndroni me shpinë të kërrusur. Duart i keni poshtë. Shikoni poshtë në tokë. Bëni shprehje të pikëlluar të fytyrës.
5. E ngushëlloj veten: Vendosni duart rreth vetes në formë të përqaimit.
6. Unë jam i lumtur: I çoni duart në ajër. Buzëqeshni.

7. Unë jam i hidhëruar. Godisni me shputën e këmbës në tokë, i kërcëlloni dhëmbët dhe shikoni me hidhërim.

8. Unë jam i lumtur: I çoni duart në ajër, kërceni disa herë poshtë-lartë.

9. Krenohem me veten: I bini vetes në shpinë, sepse keni bërë diçka të mirë.

Nxënësit e tjerë të paraleles me ndihmën e emotikonëve për çdo shembull të demonstruar, e tregojnë ndjenjën që e njohin.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?



INTERNETI

(3 orë)



Orë mësimore 1

Çfarë paraqet interneti?

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësjë:

- Shpjegon (përmes shembullit) çfarë paraqet interneti.

Burime për orën:

- kompjuter;
- lidhje interneti;
- tabelë ose tabelë inteligjente;
- fletore;
- figura ngjithëse;
- marker;
- hamer;
- fllomaster.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Leximi i një teksti të shkurtër (realizimi 5 minuta)

Mësimdhënës lexon pjesë nga ditari i Arbenit.

“Nëna hyri në dhomën e ndejës dhe u ul në kolltuk. E ndezi televizorin, nuk kishte asnjë program interesant, prandaj e morri telefonin. Dëshironte të shohë diçka në Instagram, por nuk kishte lidhje interneti. Në atë moment hyri edhe babai. Tha se i janë lajmëruar nga puna dhe se duhet urgjentisht të dërgojë email. Në laptop nuk kishte internet, ndërsa edhe në telefon nuk kishte lidhje. Vëllai im vrapoi në dhomën e tij dhe kërkoi që t’ia lëshojnë filmin e tij të preferuar, të cilin ia premtuan se do ta zbresim nga interneti.

Ndodhi situatë stresuese. U lajmëruam tek operatori ynë. Kabllot ishin të shqyera nga moti i lig, që përfshiu qytetin tonë. Na njoftuan se do të kemi internet në mëngjes. Të gjithë me një zë thamë – NË MËNGJES?!”

Mësimdhënësi dhe nxënësit diskutojnë lidhur me tekstin rreth pyetjeve në vijim:

- Çfarë mendoni, si prindërit tuaj e kanë kaluar kohën e lirë pa internet? Si i kanë përfunduar detyrat?
- Vallë mund ta mendoni jetën pa internet? Si do të dukej ajo?
- Çfarë mendoni, si do të përmbusheshin detyrimet e përditshme dhe të punës nëse një kohë të gjatë nuk ka internet?

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Çfarë paraqet interneti? (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësi tregon fotografi (Fotografia 1), në të cilën ka ilustrim të rrjetit të internetit. U shtron disa pyetje nxënësve lidhur me fotografitë:

- Çfarë shikoni në fotografi?
- Cilat pjesë të fotografisë i keni të njohura?
- A ka ndonjë lidhshmëri midis aparateve?
- Si janë të lidhur midis vete?

Çdo nxënësi merr fletë pune (Fletë Pune 1). Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se në fletën e punës ka dru të degëzuar, ndërsa ata duhet të mendojnë se druri paraqet rrjet të internetit.

Çdo përfundim i degëve të drurit paraqet një aparat (kompjuter, telefon, televizor, tablet, laptop) dhe druri mund të ketë mijëra aparate, që janë të lidhura me degët, përmes së cilave "komunikojnë njëri me tjetrin, marrin dhe shpërndajnë informacione, duke përdorur aplikacione të ndryshme".

Nxënësit marrin detyrim që të ngjyrosin dhe t'i presin vizatimet nga aparatet, ndërsa më pas t'i ngjisin në degët e drurit (Shtojca 1).

Në mënyrën e njëjtë i shtojnë edhe aplikacionet në degët e lira të drurit (Shtojca 2).

Pas përfundimit të aktivitetit, nxënësit bisedojnë për atë se çfarë paraqet interneti, për çfarë shërben dhe si përdoret. Pastaj ndajnë përvojat e tyre nga kërkimi në internet, tregojnë se vallë vetë kanë kërkuar ose me ndonjë të rritur, çfarë kanë mësuar gjatë kërkimit dhe theksojnë shembuj se çfarë do të dëshironin të dinë me kërkimin përmes internetit.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Për çfarë përdoret interneti? (realizimi 15 minuta)

Mësimdhënësi u shtron pyetje nxënësve: Për çfarë tjetër përdorin internet përveç për kërkimin e informacioneve? Përgjigje të pritura nga nxënësit janë: shikimi i videove, luajtja e videolojërave, dëgjimi i muzikës. Nëse nxënësit nuk përmendin, mësimdhënësi vë në pah se në internet ka shumë informacione interesante, që mund të përdoren edhe për:


- hulumtim (llojet e kafshëve, sporteve, planetëve...);
- komunikim (të shkruarit me shokët dhe familjen, shpërndarja e informacioneve, videove ose përmbajtjeve të tjera);
- informim (mund të shikojmë kanale televizive në internet, të lexojmë informacione kur dhe ku diçka ka ndodhur);
- mësim (materiale për lëndë të ndryshme në shkollë, informacione plotësuese për mësim, tutoriale, video, leksione të ilustruara).




Reflektim

- Çfarë mësuar në orën e sotme?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?

Si duket rrjeti i internetit?











1

Shtojca

Aparate digjitale që mund të lidhen në internet







44

2

Shtojca

Aplikacione që përdoren përmes internetit



Ora mësimore 2

Kërkimi në internet përmes fjalëve çelës

Standardet e vlerësimit

Nxënësi/nxënësja:

- Përcakton fjalë kyç në fjali dhe në tekste të shkurtra.

Burime për orën:

- kompjuter;
- lidhje interneti;
- tabelë ose tabelë inteligjente;
- fletore;
- figura ngjitëse;
- markues;
- hamer;
- fllomaster.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Shfaqja "Liza në botën e çudirave do të jepet në Tetovë" (realizimi 5 minuta)

Mësimdhënësi nxënësve u lexon tekst të shkurtër.

"Nesër, **e mërkurë (27.5.2019)**, në sallën e kinemasë në Shtëpinë e Kulturës në Tetovë, me fillim në orën **18:30**, do të luhet shfaqja e dramës "Liza në botën e çudirave", me tekst të **Lewis Carrollit**, në regji të regjisores së njohur nga Kosova, **Melihate Qena**. Shfaqja garanton përjetim të vërtetë për njerëzit e të gjitha moshave, ndërsa ajo që është për theksim është se të gjithë aktorët do të jenë fëmijë të moshës **7 deri 14-vjeçare**".

Mësimdhënësi shtron pyetje, pas së cilave nxënësit duhet të fillojnë diskutim:

- Cilat fjalë i mbajtët mend nga teksti?
- Sa fjalë mbajtët mend?

Mësimdhënësi i shkruan në tabelë fjalët kyç, që nxënësit i kanë bërë të ditur. Më pas, i pyet nxënësit se vallë mund të krijojnë nga një fjali me fjalët e apostrofuara kyç, që do të ndërlidhet me tekstin që atyre iu lexua. Lexohen disa fjalë para klasës.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Identifikimi i fjalëve kyç në tekst (realizimi 20 minuta)

Nxënësit të ndarë në grupe marrin fletë me tekste të ndryshme të shkruara (nga një paragraf) në ndonjë temë (për shembull, kafshët shtëpiake, mjetet transportuese) me detyrë që t'i ndajnë fjalët më të rëndësishme, të cilat i përkasin tekstit (kafshë shtëpiake, qeni, macja, papagalli, mjet transportuese, vetura, aeroplani etj.) (Fleta e Punës 1). Pasi çdo grup do t'i lexojë përgjigjet, përmes diskutimit të hapur konkludohet se fjalët e veçuara konsiderohen si fjalë kyç, sepse e transmetojnë informacionin kryesor që e përmban teksti, përkatësisht vënë në pah temën, për të cilën flet teksti.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Loja me fjalët kyç (realizimi 5 minuta)

Nxënësit të ndarë në grupe marrin fjalë të njëjta kyç dhe kanë detyrë që të merren vesh në nivel të grupit se cilin informacion do ta shkruajnë, i cili është i lidhur me fjalët kyç (për shembull për fjalët kyç: parashikimi i motit, moti i lig, era, shira të rrëmbyeshëm, ndërprerja e energjisë dhe e internetit, ditët e ardhshme, kthjellimi). Shkruajnë në fletë të madhe të letrës. Çdo grup prezanton dhe bashkërisht krahasohen përmbajtjet e tri teksteve se vallë janë të ngjashme, të njëjta apo të ndryshme.

Konkludojmë se fjalët kyç na ndihmojnë më lehtë të mbajmë mend çfarë lexojmë dhe ta nxjerrim porosinë thelbësore të përmbajtjes që e lexojmë, e shikojmë ose e dëgjojmë.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- A ishte e lehtë të përcaktoni fjalë kyç?
- Si mund atë që keni mësuar ta përdorni në jetën e përditshme?



Fletë Pune 1

Nxënësit kanë detyrë që t'i gjejnë dhe t'i ndajnë fjalët kyç në tekst

Shembulli 1 – *Biçikleta*⁸

Biçikleta bën pjesë në mjetet transportuese, që i takojnë trafikut tokësor. Biçikleta është mjet që njeriu e lëviz me anë të pedaleve.

Biçikleta ka dy rrota të vendosura në kornizë, njëra pas tjetrës. Njeriu që e vozit biçikletë quhet biçiklist. Biçikletat e para janë paraqitur në shekullin XIX dhe prej atëherë janë prodhuar më shumë se 1 miliard biçikleta. Biçikletat voziten në një shteg të veçantë, i cili quhet shtegu i biçikletave.

Që të menaxhoni pa rrezik me biçikletën, e domosdoshme është që:

1. *Biçikleta të jetë teknikisht në rregull.*
2. *Biçiklisti t'i dijë rregullat e lëvizjes dhe rreptësisht t'i respektojë.*
3. *Të dijë të ngasë biçikletën.*
4. *Të mbajë pajisje mbrojtëse (helmetë, mbrojtës të duarve dhe të gjunjëve).*

⁸ Burimi: Çerdhja e fëmijëve «Astibo». Akses: <https://detskagradinkaastibo.mk/%D1%82%D0%B8%D0%B2%D0%BA%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%B2%D0%BE%D0%B7%D0%BD%D0%BE-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%BE-%D0%BD%D0%B0-%D0%B4%D0%B2%D0%B5-%D1%82%D1%80%D0%BA%D0%B0%D0%BB%D0%B0/>

Shembulli 2 – Pse zebra ka vija?

Shumë shkencëtare kanë tentuar të zbulojnë se pse zebraat kanë vija të bardha dhe të zeza. Ata kanë vërtetuar se me ndihmën e vijave, zebraat mbrohen nga mizat, që transmetojnë parazitë dhe shkaktajnë sëmundje të ndryshme. Deri më tani kanë ekzistuar shumë teori, midis të cilave është menduar se vijat u ndihmojnë zebrave për t'u mbuluar, se me anë të tyre e rregullojnë temperaturën trupore ose se u shërbejnë për identifikim midis zebrave të tjera.

Shembulli 3 – Lajme më të reja nga Kopshti Zoologjik në Shkup: Luanesha Aketi nga Berlini, banore e re e Kopshtit Zoologjik.¹⁰

Luanesha e Kopshtit Zoologjik në Berlin është banorja e re e Kopshtit Zoologjik në Shkup. Luanesha dymbëdhjetëvjeçare Aketi arriti në Shkup para pesë ditëve dhe veç më është duke u përshtatur me kushtet e Kopshtit Zoologjik në Shkup. Tani për tani do të jetë vetëm në vendbanimin e saj, ndërsa për disa muaj do t'i bashkohet luani, që duhet të arrijë nga Sofja. "Aketi shkëlqyeshëm u përshtat me vendbanimin e ri dhe me kujdestarët e Kopshtit Zoologjik", thotë drejtori i këtij institucioni.

Shembulli 4 – Frikacaku

Ishte njëherë një lepur. Të gjithë e quanin "Frikacaku". Lepuri dëshironte të jetë i guximshëm, por çdoherë ishte i frikësuar. Kur kishte mot të lig dhe vetëtimat godisnin fuqishëm, çdoherë fshihej te nëna e tij. Kur vinin lepujt e tjerë ta ngacmonin, ai ikte duke qarë. Ajo që më së shumti e frikësonte lepurin ishte errësira e mbrëmjes. Atëherë fillon të shikojë përbindësia dhe shpirtra gjithkund. Një mbrëmje tha: "Nuk dua më të jem Frikacaku! Dua të jem lepur i guximshëm!" Ky vendim e bëri shumë të lumtur. Pastaj, tha: "Sonte do të qëndroj jashtë vetëm. Po, ashtu do të bëj!" Lepuri e mori dritën dhe shkoi. Pastaj në mal bëhej gjithnjë e më shumë terr. Përnjëherë, lepur i qau: "Çfarë është kjo? I ngjan një përbindëshi të madh!" Lepuri menjëherë shkoi në shtëpi, por nuk dëshironte të jetë "Frikacaku". Për fat iu kujtua se ka dritë. "Do ta shoh përbindëshin nga afër", pëshpëriti. Pastaj e ndezi dritën dhe e drejtoi kah përbindëshi. "Of, ai aspak nuk paska qenë përbindësh", morri frymë. Lepuri e shkyçi dritën dhe vazhdoi të ecë. Në qiell, hëna doli pas një mjegulle të madhe, të errët. Drita e hënës depërtonte midis drunjve. Lepuri i vogël vazhdoi të ecë gjithnjë e më larg në mal, derisa erdhi deri tek një liqe i vogël. Anash kishte mijëra gurë të vegjël, të cilët nga hëna shkëlqenin si margaritarë. Lepuri i vogël shikoi në ujë dhe hëna e plotë reflektohej në ujë. "Sa është mrekulli", mendoi. Pas disa çastesh heshti. Përnjëherë u frikësua. "Fantazmë, fantazmë", filloi të qajë. "Ka fantazmë në ujë! Më shikon me sytë e mëdhenj dhe të rreptë". Lepuri për pak sa nuk e bëri urinën nga frika! Kërceu dhe dëshironte menjëherë të ik, por pa se përbindëshi gjithashtu kërceu. Lepuri i vogël u ndal dhe mendoi: "Hmm, kjo fantazmë nga diku më është e njohur". E ngriti këmbën e djathtë. Pastaj fantazma gjithashtu e ngriti këmbën e djathtë. Pastaj lepur i lëvizte veshët e tij. Fantazma gjithashtu lëvizte veshët. Në fund, lepur i hoqi gjuhën nga goja para fantazmës dhe bëri: "Baaaaa!". Ndërsa çfarë bëri fantazma? Edhe ajo hoqi gjuhën nga goja dhe bëri: "Baaaaa!". Atëherë lepur i vogël filloi të qeshë! Qeshte e qeshte dhe nuk mund të ndalej. "Kjo nuk paska qenë fantazmë", bërtiti. "Ky është reflektimi im në ujë! Ky jam unë, lepur i vogël, i pasqyruar në ujë!" Pastaj, qeshte ende. Nga shumë të qeshura, filloi të kërcejë nga një këmbë në tjetër. Kur me qeshje e largoi tërë frikën, lepur shkoi në shtëpi. U shtri në krevatin e tij dhe bëri gjumë të thellë. Nga ajo ditë, lepur i vogël bëhej më i guximshëm. Së shpejti, askush nuk e thërriste "Frikacaku".

⁹ E përshtatur nga Ohridnizuj. mk. „Zbulohet se pse zebraat kanë vija“. Akses në: <https://www.ohridnews.com/otkrieno-zoshto-zebrite-imaat-prugi/>

¹⁰ E përshtatur nga Sdk.mk. „Luanesha Aketi në Berlin, banore e re e Kopshtit Zoologjik“. Akses në: <https://sdk.mk/index.php/dopisna-mrezha/lavitsata-aketi-od-berlin-nov-zhitel-na-skopskata-zooloshka/>

Orë mësimore 3

Kërkimi në internet

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësjë:

- Gjen informacionin e nevojshëm në internet përmes kërkimit me anë të kërkuesit

Burimet e orës:

- tabelë (ose tabelë inteligjente);
- telefonat celularë ose aparatet e tjera të mençura, në të cilat mund të kërkohet;
- fletë të bardha;
- pajisje për punë.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Si kuptojmë diçka më shumë për liqenet natyrore dhe malet tona (realizimi 10 minuta)

Nxënësit në fillim të orës kuptojnë se në postën elektronike të shkollës, ka arritur një letër e një nxënësi që jeton në Itali. Njëri nga nxënësit e lexon letrën. (Shtojca 1).

*„Përsëritje shokë të dashur,
Qthem Besnik, jam 8-vjeçar dhe tani jetoj në Itali. Me prindërit e mi duam të vijmë pranë liqenit ose malit në vendin tuaj. Me të vërtetë do të na ndihmonte shumë nëse na jepni informacion se ku mund t'i kalojmë pushimet.*

*Paraprakisht ju falënderoj shumë,
Besniku”*

Nxënësit diskutojnë se ku mund të gjejnë informacione që t'i ndihmojnë Besnikut? (Përgjigjet duhet të çojnë drejt burimeve në vijim: në libra, në lëndën Shoqëri mësohet për vendin tonë, në internet...) Mësimdhënësi e orienton diskutimin drejt kërkimit në internet. Nxënësit shpjegojnë se çfarë nënkuptojnë me termin “kërkim” dhe bisedojnë me mësimdhënësin në këtë drejtim:

- Vallë dikush ka kërkuar diçka në internet? Në çfarë mënyre?
- Cilat fjalë kyç na nevojiten që të vijmë deri te informacioni i dëshiruar gjatë kërkimit në internet, që t'i ndihmojmë Besnikut?

Mësimdhënësi i shkruan fjalët kyç në tabelë (Liqeni i Ohrit, Pelister, ku ka plazh në Dojran, pushim në Kodrën e Diellit...).

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Kërkimi në internet përmes kërkuesve, të dedikuar për fëmijë (realizimi 30 minuta)

Fillojmë bisedën rreth pyetjeve:

- Çfarë janë kërkuesit në internet?
- A dini ndonjë nga ata?
- A keni përdorur kërkues që është i dedikuar për fëmijët?

Mësimdhënësi i shënon kërkuesit e apostrofuar, që i thonë nxënësit (nëse thonë) dhe i plotëson ato që nuk i kanë thënë (për shembull, www.kidzsearch.com).

Nxënësit të ndarë në grupe marrin udhëzime se cili grup çfarë do të kërkojë që t'i ndihmojë Besnikut:

grupi 1 – informacione të rëndësishme për Liqenin e Ohrit

grupi 2 – informacione të rëndësishme për Liqenin e Prespës

grupi 3 – informacione të rëndësishme për Liqenin e Dojranit

grupi 4 – informacione të rëndësishme për Malin Kodra e Diellit – Parkun Kombëtar Kodra e Diellit

grupi 5 – informacione të rëndësishme për Galicicën – Parkun Kombëtar Galicica

grupi 6 – informacione të rëndësishme për Bistrën – Parkun Kombëtar Mavrovë

Nxënësit kanë për detyrë të përcaktojnë se çfarë duan të dinë dhe cilat fjalë kyç duhet t'i përdorin për kërkim në internet. Mësimdhënësi u jep udhëzime nxënësve për kërkim në internet, ndërsa nëse disa nga nxënësit janë të zhdërvjelltë për këtë, u jep mundësi të shpjegojnë para nxënësve, por në fund mësimdhënësi i shkruan në tabelë hapat themelore të kërkimit:

(1) hapet “kërkuesi” (Google.com, Kidzsearch.com);

(2) vendoset fjala e saktë kyç ose kombinimi i disa fjalëve kyç ose ndonjë pyetje e shkurtër lidhur me informacionin që dëshirojnë ta mësojnë;

(3) klikohet “kërko” (search) ose susta “enter” dhe

(4) hapen vegëza që i ofrojnë informacionet e kërkuara;

(5) i shkruajnë fjalët kyç, të cilat i kanë kërkuar dhe vegëzat në të cilat janë gjetur informacione interesante.

Mësimdhënësi tregon përmes tabelës së mençur kërkim në internet sipas hapave.

Çdo grup tregon kërkim në internet përmes tabelës së mençur sipas hapave.

Çdo grup kërkon në internet, duke përdorur disa telefona celularë (me lejen e mësimdhënësit) ose aparateve të tjera të mençura, në të cilat mund të kërkohet me dedikim (tabletë) vetëm për orën konkrete. Pastaj i prezantojnë informacionet e marra para të tjerëve.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Nga fjalët kyç deri te informacioni i nevojshëm (realizimi 5 minuta)

Në diskutim të hapur, me tërë klasën krahasohen fjalët kyç përkatësisht pyetjet e shkurtra që çdo grup i përdor gjatë kërkimit dhe vërtetohet rëndësia e tyre për marrjen e informacioneve.

Përfaqësuesi i çdo grupi e lexon informacionin e shkurtër, që e kanë ndarë, me qëllim që t'i ndihmojnë Besnikut dhe t'i bëjnë me dije se cilat vende t'i vizitojnë.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mundet atë që e keni mësuar ta përdorni në jetën e përditshme, kur dëshironi të përdorni fjalë kyç që do të ndërlihen me qëllimin ose aktivitetin tuaj?

KRIJMI I POROSIVE MEDIATIKE

(2 orë)



Ora mësimore 1

Mënyrat e prezantimit të informacioneve

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësjë:

- Përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacioneve (tekst, fotografi, videopërbajtje).

Burime për orën:

- tekste informative;
- fotografi;
- fletë të bardha;
- pajisje.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Si të informohem (realizimi 5 min)

Nxënësit diskutojnë për atë se si janë informuar për diçka ose për ndonjë ndodhi aktuale në tri ditët e fundit. Duhet të tregojnë se a kanë parë video në internet ose në televizion, vallë kanë parë ndonjë fotografi apo kanë lexuar ndonjë tekst. Përgjigjet shkruhen në tabelë.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Krijimi i përmbajtjeve në ndonjë temë të caktuar (realizimi 30 minuta)

Nxënësit, të ndarë në disa grupe, tërheqin fletë, në të cilat janë prezantuar dy përmbajtje – një informatë e ofruar përmes ndonjë teksti dhe një informatë tjetër e ofruar përmes fotografisë. Për shembull, në një letër mund të jetë:

- [1]** e shkruar se një vajzë ka pasur qen të zi si kafshë shtëpiake, ndërsa shoqja e saj akvarium me peshq. Grupi duhet ta prezantojë tekstin me fotografi, ilustrime dhe simbole;
- [2]** fotografi e treguar e fëmijëve gjatë festimit të një ditëlindjeje. Grupi duhet të shkruajë një tekst të shkurtër (5 fjali);
- [3]** Varësisht nga tema e fletës së tërhequr (të shpjguara nën 1 dhe 2), grupi i tretë duhet të mendojë dhe shpjegojë çfarë do të shfaqë përmes videoxhimit për shembullin konkret.

Çdo grup e prezanton punën e tij para të tjerëve. Vetëm grupi që përgatit videoxhirim, "aktron" drejtpërdrejt si do të dukej ajo që do ta xhironin për prezantimin e informacionit përmes videos.

Pas prezantimit të punës në grupe, nxënësit shpjegojnë se cilat janë dallimet gjatë prezantimit të informacionit përmes tekstit, fotografisë ose përmes videoxhimit.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti


Prezantimi i informacioneve (realizimi 5 minuta)

Nxënësit së bashku me mësimdhënësin bisedojnë për atë se në cilën mënyrë më së lehti informohen/vijnë deri te informacionet – vallë kur lexojnë tekst, shikojnë fotografi ose përmbajtje me video. Në një temë që do t'ua japë mësimdhënësi, ata duhet të shpjegojnë se në cilën mënyrë do ta prezantojnë informacionin, me qëllim që t'i informojnë të tjerët. Disa nxënës i prezantojnë idetë e tyre para klasës dhe japin shpjegime pse kanë zgjedhur pikërisht atë mënyrë të prezantimit të informacioneve.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si ndiheni përderisa përgatiteni për prezantimin e informacioneve?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?



Ora mësimore 2

Krijimi i porositë të zakonshme mediatike

Standardi i vlerësimit

Nxënësi/nxënësjë:

- ↳ Krijon përmbajtje mediatike në një temë të caktuar, e përgatitur me tekst dhe fotografi, vetëm fotografi ose videoxhirim.

Burime për orën:

- ↳ tabelë (ose tabelë inteligjente);
- ↳ fletë të bardha;
- ↳ hamer;
- ↳ përmbajtje video;
- ↳ pajisje.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Tekst dhe fotografi, vetëm fotografi ose videoxhirim (realizimi 7 minuta)

Mësimdhënësi hap diskutim për atë se çfarë formatesh mediatike janë më të përshtatshme për llojet e ndryshme të platformave mediatike (për shembull për internet, për televizion, për gazetë/media të shkruar, për radio). Pas diskutimit, mësimdhënësi konkludon se nëse duan të krijojmë ndonjë përmbajtje mediatike, duhet ta dimë prej më herët se vallë mund të përdorim tekst, fotografi, video, audio etj. (Shtojca 1).

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Nxënësit në rolin e gazetarëve krijojnë përmbajtje (realizimi 25 minuta)

Nxënësit i vendosim në rolin e gazetarëve, që duhet të shkruajnë përmbajtje për një temë të caktuar, për shembull, videolojë, seri për fëmijë, temë/përmbajtje nga lënda Shoqëri, të ushqyerit e shëndetshëm, trupat qiellorë dhe kozmikë (mund ta përdorin si burim materialin për mësim nga shkencat e natyrës).

Nxënësit, të ndarë në grupe, zgjedhin njërin nga temat e propozuara, për të cilat duhet të krijojnë përmbajtje mediatike, e hartuar nga një tekst i shkurtër, që vetë do ta mendojnë, fotografi/ilustrime, që vetë do t'i përdorin, ose simbole/emotikone që do t'i zgjedhin. Teksti duhet të mos jetë më i gjatë se pesë fjali, ndërsa fotografite/ilustrimet mund vetë të vizatohen/rvizatohen/priten nga ndonjë material i shtypur. Çdo grup e përgatit përmbajtjen mediatike për prezantim në hamer.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Prezantimi i përmbajtjeve mediatike (realizimi 10 minuta)

Përgatitje në grupe për prezantimin e punimeve. Para se të prezantohet, bisedohet për rregullat e shfaqjes së punimeve. Rregulli është se çdo grup ka katër minuta për prezantim. Çdo grup fiton dy lëvdata dhe një sygjërim. Çdo grup duartroket për motivimin e të tjerëve.

Në fund, përfaqësues i çdo grupi prezanton, duke respektuar rregullat dhe kriteret e prezantimit.



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Cila pjesë më së shumti ju pëlqeu nga aktivitetet e orës? Pse?
- Si mundet që atë që e kemi mësuar ta përdorim në jetën e përditshme?

1

Shtojca

Shembuj të përmbajtjeve mediatike, tekst dhe fotografi, fotografi ose videoxhirim.

Tekst dhe fotografi: <https://fashionel.mk/intervju/majkata-shto-gi-servira-najveselite-chinii-so-zdrava-hrana>

Video: <https://www.youtube.com/watch?v=pnFi2H0les0>

Fotografi: https://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2014/05/vegetable_fruits_healthy_foods-wide.jpg

